

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,  
LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË  
NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, në Bashkinë Gjirokastër NJMBNJ shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

- Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve Publike në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike në Bashkinë Gjirokastër.
- Kategoria III - 2.

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

LËVIZJE PARALELE

20.05.2026

NGRITJE NË DETYRË

25.05.2026

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:**

1. Siguron përdorimin sa me ekonomik dhe efektiv të fondeve publike dhe zbatimin e procedurave të prokurimit, në mbështetje të legjislacionit në fuqi;
2. Siguron transparencën dhe jodiskriminimin gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për mallrat, shërbimet, punët publike dhe investimet e lidhura me to;
3. Realizon brenda afatit të përcaktuar nga ana ligjore të gjitha prokurimet për mallrat, shërbimet, punët publike apo investimet, duke bërë të mundur realizimin e objektivave primare të Bashkisë Gjirokastër;
4. Rrit efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit për mallrat, shërbimet, punët publike dhe investimet e lidhura me to, të realizuara nga Bashkia Gjirokastër, duke siguruar një përdorim sa më të mirë të fondeve publike;
5. Realizon ndarjen e punës dhe të japë instruksione dhe ndihmën e domosdoshme për vartësit direkt për përmbushjen e detyrave;
6. Të jetë pjesë e komisioneve të ndryshme të përcaktuara me urdhër të vecantë nga ana e titullarit të institucionit apo zëvendës titullarit të AK.
7. Të mbajë korespondencën e zyrës dhe ta shpërndajë atë tek specialistët përkatës për kthim përgjigje brenda afateve ligjore.

**1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

**1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a - Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III - 2;
- b - Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c - Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" 'Master Profesional' në Shkenca Shoqërore ose në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b - Të kenë 3 vite përvojë pune në profesion.
- c - Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

---

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- b-Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h-Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet dorazi në NJMBNJ.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 20.05.2026 (është 10 ditë)

---

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 22.05.2026, NJMBNJ do të shpallë në Stendat e Bashkisë dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga NJMBNJ për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

---

## **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

## **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuri mbi ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Njohuri mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Njohuri mbi Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Vendim nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me vendimin nr. 823, datë 21.10.2020;
- Udhëzim nr. 07 datë 30.07.2021 Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike;

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[ëëë.dap.gov.al](http://ëëë.dap.gov.al)”

<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJMBNJ do të shpallë fituesin në Stendat e Bashkisë dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJMBNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2 NGRITJA NË DETYRË**

---

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

## 2.1

### **KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

---

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a - Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b - Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c - Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" ose 'Master Profesional' në Shkenca Shoqërore ose në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë .
- b - Të kenë me shumë së 3 vite përvojë pune në profesion.
- c - Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

## 2.2

### **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen dorazi pranë NJMBNJ , duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit .

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave dorazi për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës: 25.05.2026

## 2.3

### **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën 05.06.2026 NJMBNJ do të shpallë në Stendat e Bashkisë dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën

e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

**2.4**

#### **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Njohuri mbi ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Njohuri mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003,“Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Njohuri mbi Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Vendim nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, i ndryshuar me vendimin nr. 823, datë 21.10.2020;
- Udhëzim nr. 07 datë 30.07.2021 Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike;

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5**

#### **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[ëëë.dap.gov.al](http://ëëë.dap.gov.al)”

<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

**2.6**

#### **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJMBNJ do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). NJMBNJ do të shpallë fituesin në Stendat e Bashkisë dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”.

**DREJTOR**

**Mirlinda Shabani**